Në rast të pamundësisë së Huamarrësit për të kryer në datën e duhur pagesën e çdo shume të pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi do të paguajë interes mbi këtë shumë nga data e kësaj mos-pagesë deri në datën e pagesës aktuale në normën e caktuar në Shtojcën 3. Kamatëvonesa sipas këtij Seksioni 3.3 do të kalkulohet në bazë të numrit aktual të ditëve të kaluara dhe një viti prej 360 ditësh dhe do të jetë e kërkueshme dhe e pagueshme në Datat e Shlyerjes së Interesit.

4. **TARIFAT DHE SHPENZIMET**

4.1 **Tarifa e zotimit**

a) Huamarrësi ia paguan huadhënësit, për periudhën ("periudhën e llogaritjes") nga dhe duke përfshirë datën e mbylljes deri në, dhe duke përfshirë ditën, cilado që është më herët nga:

(i) dita e fundit e periudhës së disponueshmërisë dhe

(ii) dita në të cilën shuma kreditore është disbursuar plotësisht,

një tarifë të pakthyeshme të zotimit në normën e specifikuar në shtojcën 3.

b) Tarifa e zotimit e pagueshme në përputhje me Seksionin 4.1 a) llogaritet nga Huadhënësi në bilancin e patërhequr të Shumës së Kredisë në Datën e Mbylljes dhe në çdo Datë të Shlyerjes së Interesit gjatë Periudhës së Disponueshmërisë ("Data e Llogaritjes") mbi bazën e numrit aktual të ditëve të kaluara në periudhën përkatëse dhe në një viti prej 360 ditësh, si dhe paguhet në pagesa te prapambetura nga Huamarrësi tek Huadhënësi. Pagesa e parë e tarifës së zotimit si me poshtë bëhet në Datën e Shlyerjes së Interesit, menjëherë pas datës së hyrjes në fuqi dhe çdo pagesë pasuese e tarifës së zotimit bëhet në Datën e Shlyerjes së Interesit menjëherë pas Datës së Llogaritjes.

4.2 **Tarifa e Menaxhimit**

Huamarrësi, brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas Datës së Mbyllje, do t'i paguajë

Huadhënësit tarifën e menaxhimit të specifikuar në Shtojcën 3 të llogaritur mbi Shumën e Kredisë.

4.3 **Primi i Garancionit të OeKB**

a) **Primi i Garancionit të OeKB të pagueshme në avansë**

Huamarrësi, brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas Datës së Mbylljes, do t'i paguajë Huadhënësit (për llogarinë e OeKB) një pjesë fillestare të Primit të Garancionit të OeKB në shumën e specifikuar në Shtojcën 3.

b) **Primi i Garancionit të OeKB-së që paguhet si marzhë**

Duke filluar me Datën e Parë të Shlyerjes së Interesit pas Datës së Mbylljes, Huamarrësi do t'i paguajë Huadhënësit (për llogarinë e OeKB) pjesën e mbetur të Primit të Garancionit të OeKB të e pagueshme si marzhë në normën e llogaritur nga OeKB dhe e specifikuar në Shtojcën 3 Një pjesë e tillë e Primit të Garancionit të OeKB paguhet çdo tre muaj me pagesa te prapambetura në secilën Datë të Pagesës së Interesit.

c) Shuma përfundimtare e Primit të Garancionit të OeKB e pagueshme në avansë dhe Primi i Garancionit të OeKB që paguhet si marzhë, si dhe orari i pagesës së Primit të Garancionit të OeKB që paguhet si marzhë do të përcaktohet nga OeKB pas lëshimit të Garancionit të OeKB. Huadhënësi njofton menjëherë Huamarrësin për shumat e tilla përfundimtare dhe për orarin e pagesës në përputhje me rrethanat, dhe njoftimi i tillë bëhet pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

d) Nëse shuma përfundimtare e Primit të Garancionit së OeKB për tu paguar me avansë, e përcaktuar dhe e njoftuar sipas paragrafit të mësipërm (c), e tejkalon shumën e specifikuar në Shtojca 3, Huamarrësi menjëherë që në kërkesën e parë nga Huadhënësi e dëmshpërblen Huadhënësin për shumën e tepricës së tillë.

4.4 **Kostot e rritura të OeKB**

Në rast të ndonjë ndryshimi të kësaj Marrëveshjeje (duke përfshirë pa kufizim ndonjë ndryshim në shumën kryesore të mbuluar nga Garancioni i OeKB ose ndonjë zgjatje të ndonjërës prej Datave të shlyerjes së Detyrueshme), OeKB mund të ri-llogarisë shumën e tarifave të saj në lidhje me Garancionin e OeKB dhe mund t'ia ngarkojë Huadhënësit një prim shtesë. Huadhënësi njofton menjëherë Huamarrësin për çdo rritje të tillë të tarifave në lidhje me Garancionin e OeKB-së, dhe Huamarrësi brenda 10 ditëve të punës nga kërkesa e parë e bërë nga Huadhënësi do të dëmshpërblejë Huadhënësin për shumën e çfarëdo primi të tillë shtesë.

4.5 **Tarifa e trajtimit e OeKB**

Huamarrësi, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga Data e Mbylljes, do t'i paguajë Huadhënësit (për llogarinë e OeKB-së) tarifën e pakthyeshme të trajtimit në shumën e specifikuar në Shtojcën 3.

4.6 **Kostot dhe Shpenzimet**

a) Huamarrësi, brenda 30 (tridhjetë) ditëve të punës nga parashtrimi i kërkesës i paguan Huadhënësit shumën e të gjitha kostove dhe shpenzimeve (nëse ka ndonjë) të bëra me arsye dhe të dokumentuara nga Huadhënësi në lidhje me negocimin, përgatitjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

b) Huamarrësi, brenda 30 (tridhjetë) ditëve të punës nga parashtrimi i kërkesës, i paguan Huadhënësit shumën e të gjitha kostove dhe shpenzimeve të dokumentuara (duke përfshirë, por pa u kufizuar në tarifat ligjore, shpenzimet e përkthimit dhe udhëtimit) të bëra nga Huadhënësi në lidhje me zbatimin e, ose ruajtjen e ndonjë të drejte sipas kësaj Marrëveshjeje.

c) Të gjitha taksat, detyrimet, shpenzimet ose tarifat e tjera të vendosura mbi Huadhënësin në Republikën e Kosovës në lidhje me këtë Marrëveshje dhe transaksionet e parashikuara në këtë Marrëveshje, janë për llogari të Huamarrësit dhe paguhen nga Huamarrësi tek Huadhënësi.

5. **SHLYERJA**

5.1 **Shlyerja e Detyrueshme**

Huaja e papaguar në fund të Periudhës së Disponueshmërisë shlyhet nga Huamarrësi në Datat e Shlyerjes së Detyrueshme, të specifikuar në Shtojcën 3. Huamarrësi mund të mos merr prapë hua ndonjë pjesë të Shumës së Kredisë e cila është shlyer apo parapaguar.

5.2 **Parapagimi vullnetar**

a) Huamarrësi mund te parapaguaje huan plotësisht ose pjesërisht (nëse pjesërisht, në shumën e përcaktuar në shtojcën 3 ose shumëfishat integrale të saj), pas dhënies se një njoftimi me shkrim te paktën 30 (tridhjete) dite kalendarike para (ky njoftim do të jetë i parevokueshëm) datës së propozuar të parapagimit për Huadhënësin, në bazë të aprovimit të OeKB-se dhe pagesave te çdo kostoje ekuivalente me humbjen e llogaritur (siç mundet OeKB, në diskrecionin e vet, ta ngarkoj Huadhënësin) të shkaktuara nga Huadhënësi.

b) Nëse bëhet gjatë periudhës së disponueshmërise, çdo parapagim i tillë do të reduktoje shumën e kredisë me një shumë të barabartë me këtë parapagim. çdo reference ndaj shumës se kredisë në këtë Marrëveshje me pas konsiderohet të jetë referencë ndaj shumës së caktuar në shtojcën 3, të reduktuar. Nëse bëhet pas mbarimit të periudhës se disponueshmërisë, çdo parapagim i tillë do të aplikohet për të përmbushur kështet e ardhshme të parapagimit.

c) Huamarrësi nuk mund ta ri huazojë ndonjë pjesë të Shumës së Kredisë që është parapaguar.

6. **PAGESAT**

6.1 **Njoftimi i Pagesës**

a) Jo më vonë se 14 (katërmbëdhjetë) ditë kalendarike para çdo Date të shlyerjes së Interesit ose, sipas rastit, Datës së Shlyerjes së Detyrueshme, Huadhënësi e njofton me shkrim Huamarrësin në lidhje me ato shuma që duhet te paguhen nga Huamarrësi për Huadhënësin në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje sa i përket kryegjësë, Primit të Garancionit të OeKB të pagueshme si marzhë ne bazë të Seksionit 4.3 b), tarifa e zotimit, me kusht që pamundësia për dhënien e këtij njoftimi të mos lehtësojë Huamarrësin nga detyrimi i tij për të shlyer pagesa të këtyre shumave të lartpërmendura, kur bëhen të pagueshme.

b) Nëse ndonjë shumë e caktuar e Huas është bërë brenda 15 ditëve para Datës së Shlyerjes së Interesit, interesi ose çdo shumë tjetër e pagueshme në lidhje me këtë Datë të Pagesës së Interesit do të bartet dhe do të bëhet i pagueshëm për Huadhënësin në Datën e ardhshme të shlyerjes së Interesit.

6.2 **Mënyra e Pagesës**

a) Në bazë të kësaj Marrëveshjeje, Euro është valuta e llogarisë dhe pagesa për secilën shumë që duhet të paguhet nga Huamarrësi, me kusht që secila pagesë në lidhje me kostot, shpenzimet ose taksat të bëhet në valutën në të cilën kanë lindur kostot, shpenzimet ose taksat. Secila shumë e shprehur për t'u paguar në ndonjë valutë tjetër nga Euro, duhet të paguhet në atë valutë tjetër.

b) Në çdo datë në të cilën Huamarrësi kërkohet të bëjë një pagesë sipas kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi do t`i vë atë në dispozicion për Huadhënësit (përveç nëse shprehet ndryshe në këtë Marrëveshje) në vlerën e shumës në datën e caktuar për pagesë në kohën dhe shuma të specifikuara nga Huadhënësi si është zakon në kohën për shlyerjen e transaksioneve në valutën përkatëse në vendin e pagesës.

c) Çdo pagesë e pagueshme që do të behet në ndonjë ditë që nuk është ditë pune, do të bëhet në ditën pasuese e cila është ditë pune.

d) Të gjitha pagesat nga Huamarrësi ndaj Huadhënësit sipas kësaj Marrëveshjeje do të bëhen në një llogari të tillë në qendrën kryesore financiare të vendit të asaj valute (ose, në raport me Euron, në Vjenë) siç do ta specifikoj Huadhënësi në njoftimin me shkrim.

6.3 **Heqja dorë nga kompensimi ose kundërkërkesa**

Huamarrësi në këtë mënyrë heq dorë pjesërisht apo plotësisht nga e drejta e kompensimit apo kundërkërkesës që mund të ketë për sa i përket çdo shumë të pagueshme kundrejt Huadhënësit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe bie dakord që nuk do të ndaloj pagesa, për çfarëdolloj arsyeje të shumave për t'u paguar. Në veçanti, Huamarrësi nuk do të ndaloj pagesa të shumave të për t`u shlyer ndaj Huadhënësit sipas kësaj Marrëveshjeje për arsye të pretendimeve, të drejtave për tu për të vepruar, të drejtave ose kërkesave kundër Eksportuesit të Projektit ose furnizuesve të tjerë për sa i përket Projektit.

6.4 Pagesat e lira nga Tatimi në Burim dhe ngarkesat tjera

Të gjitha pagesat e realizuara nga ana e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje do të bëhen pa kompensim ose kundërkërkesë dhe të lira dhe të pa reduktuara për sa i përket çdo takse, detyrimi, zbritje, ndalimi apo nga çfarëdo tarife tjetër aktuale apo në të ardhmen të Republikës së Kosovës, përveç kur Huamarrësit i kërkohet me ligj ta bëjë zbritje të tilla. Nëse një gjë e tillë kërkohet me ligj, shuma për tu paguar nga Huamarrësi për sa i përket shlyerjes në fjalë rritet deri në nivelin e nevojshëm për të siguruar që pas zbritjes së taksave, detyrimeve, reduktimeve, ndalimeve apo ngarkesave tjera, Huadhënësi të marrë në datën përkatëse të shlyerjes në fjalë një shumë neto të barabartë me shumën që do të merrte në rast se nuk do të kërkohej të bëhej zbritja e taksave, detyrimeve, reduktimeve, ndalimeve apo ngarkesave tjera në fjalë. Huamarrësi menjëherë i dorëzon Huadhënësit çdo faturë, vërtetime ose dëshmi të tjera që vërteton shumat (nëse ka) e paguara apo për t`u paguar në lidhje me zbritjet apo ndalimet si më sipër.

6.5. Kostot e rritura

a) Nëse rezultati i (x) një ndryshim në, ose prezantimi të një ligji, rregulloreje ose një kërkese rregullatorë; ose (y) ndryshimi në interpretimin ose zbatimin e tyre ose respektimi nga ana e Huadhënësit të çdo udhëzimi, kërkese ose detyrimi (nëse e ka fuqinë e ligjit ose jo) të ndonjë banke qendrore, autoriteti monetar, rregullator ose autoriteti tjetër (duke përfshirë, në çdo rast, pa kufizim, ato që lidhen me mjaftueshmërinë e kapitalit, likuiditetin, aktivet rezervë dhe depozitat e veçanta) është:

   (i) të rrisë koston ose të vendosë kosto shtesë për Huadhënësin për vënien ose ruajtjen në dispozicion të zotimit të tij ose ruajtjen ose financimin e Huas; dhe/ose

   (ii) të reduktojë shumën e pagueshme ose fitimin real për Huadhënësin sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe/ose

   (iii) të reduktojë normën e fitimit të Huadhënësit mbi kapitalin e tij të përgjithshëm për shkak të një ndryshimi në mënyrën në të cilën kërkohet për të alokuar burimet e kapitalit për detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe/ose

   (iv) të kërkojë Huadhënësit të kryejë një pagesë ose të heqë dorë nga një fitim mbi ose të llogaritur, ndaj çdo shume të marrë ose që duhet të merret nga ai sipas kësaj Marrëveshjeje,

   atëherë Huadhënësi njofton Huamarrësin me shkrim për lindjen e ndonjë kostoje të tillë, reduktimi të tillë, pagese ose heqje dorë nga një fitim, dhe Huamarrësi i paguan Huadhënësit me kërkesë, çdo kosto të tillë, reduktim, pagesë ose heqje dorë nga fitimi tanimë të lindur ose të pësuar nga Huadhënësi.

b) Seksioni 6.5 a) nuk përfshin kostot e rritura të cilat janë rezultat i përkeqësimit të klasifikimit te obligacioneve afatgjatë të pasiguruara dhe të pa-përmirësuara të Huadhënësit në BBB- sipas Standard & Poor's Rating Services ose nën Baa3 sipas Moody's Investor Services Limited ose një klasifikim të krahasueshëm nga ndonjë agjenci e njohur ndërkombëtarisht e klasifikimit kreditor.

c) Çfarëdo vërtetim i Huadhënësit në lidhje me kosto, reduktim, pagesë ose heqje dorë nga një fitim, në mungesë të një gabimi të dukshëm, do të jenë prova përfundimtare dhe detyruese për Huamarrësin.

d) Për qëllimet e këtij Seksioni 6.5, Huadhënësi mund të alokojë në mirëbesim ose shpërndajë kostot dhe/ose humbjet mes aktivëve dhe pasivëve të tij (ose ndonjë kategorie të tyre) në bazën që çmon të nevojshme.

6.6 **Caktimi i pagesave**

a) Të gjitha pagesat e pranuar nga Huadhënësi prej Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje (përveç kur Huadhënësi ndryshon urdhrin e zbatimit) do të zbatohen nga Huadhënësi kundrejt pagesës së shumave të kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje në rendin e mëposhtëm, dhe Huamarrësi bie dakord për zbatimin e këtyre pagesave në këtë rend (dhe për çdo ndryshim të tyre nga Huadhënësi:

(i) shumat e kërkueshme sipas Seksionit 4.2 (*Tarifa e Menaxhimit*);

(ii) shumat e kërkueshme sipas Seksionit 4.5 (*Tarifa e trajtimit e OeKB*);

(iii) shumat e kërkueshme sipas Seksionit 4.3 (*Primi i garancionit të OeKB*);

(iv) shumat e kërkueshme sipas Seksionit 4.1 (*Tarifa e zotimit*);

(v) shumat e kërkueshme sipas Seksionit 4.6 (*Kostot dhe Shpenzimet*);

(vi) shumat e kërkueshme sipas Seksionit 3.3 (*Kamatëvonesa*);

(vii) shumat e prapambetura sipas Seksionit 3.1 (*Interesi mbi Llogarinë e Shumës së Kredisë*);

(viii) shumat e prapambetura sipas Seksionit 5.1 (*Shlyerja e Detyrueshme*);

(ix) shumat e kërkueshme sipas Seksionit 3.1 (*Interesi mbi Llogarinë e Shumës së Kredisë*);

(x) shumat e kërkueshme sipas Seksionit 5.1 (*Shlyerja e Detyrueshme*);

(xi) shumat e kërkueshme sipas Seksionit 5.2 (*Parapagimi vullnetar*);

(xii) çdo shumë tjetër të kërkueshme (nëse ka).

b) Huadhënësi do të informojë menjëherë Huamarrësin rreth aplikimit të pagesave

të bëra. Çdo udhëzim për të kundërtën i dhënë Huamarrësi nuk merret parasysh.

c) Huamarrësi pranon që OeKB, sipas garancionit të OeKB, të ketë rezervuar ndaj Huadhënësit të drejtën për të ndryshuar caktimin e pagesave të përcaktuara më sipër. Në këtë rast, Huadhënësi do të informojë menjëherë Huamarrësin me shkrim dhe Huamarrësi do të pranojë caktimin e OeKB-së dhe do të marrë përsipër të shlyejë Huan dhe çdo shumë tjetër të papaguar sipas kësaj Marrëveshjeje të njoftuar në atë kohë (duke përfshirë një llogaritje të hollësishme) nga Huadhënësi për Huamarrësin.

6.7 **Kompensimi**

a) Huadhënësi mund të kompensojë çdo detyrim të maturuar të kërkueshëm nga huamarrësi sipas kësaj marrëveshjeje ndaj çdo detyrimi të maturuar që huadhënësi i detyrohet huamarrësit, pavarësisht vendit të pagesës, degës ose valutës së gjithsecilit detyrim. Nëse detyrimet janë në valuta të ndryshme, huadhënësi mund të konvertojë secilin detyrim në vlerën e këmbimit në treg në rrjedhën saj të e zakonshme të punës me qëllim të kompensimit.

b) Sipas nenit 11 paragrafi 4 të "Einlagensicherungs- und Anlegerentschädigungsgesetz – ESAEG (Gazeta Ligjore Federale I. Nr. 117/2015)" të Austrisë, detyrimet e huamarrësit ndaj huadhënësit që kanë arritur datën e pagesës ose para datës në të cilën ndodh rasti i mbrojtjes (p.sh kështet e kreditimit të prapambetura) mund të kompensohen ndaj depozitave të huamarrësit gjatë llogaritjes së shumës së rikthyeshme në një rast mbrojtës.

7. **KUSHTET PARAPRAKE**

a) Kjo Shumë e Kredisë do të vihet në dispozicion për Huamarrësin në datën ("**Data e Mbylljes**") kur Huadhënësi i konfirmon Huamarrësit se ka pranuar në formën dhe përmbajtjen e kënaqshme për të (apo në kuptimin e çfarëdo dokumenti të tillë apo dëshmie, ka hequr dorë nga pranimi i tyre) dokumentet dhe dëshmitë e mëposhtme:

(i) kopjen e Marrëveshjes së Blerjes;

(ii) një vërtetim të lëshuar nga një zyrtar i autorizuar i Eksportuesit të projektit në një datë jo me larg se katërmbëdhjetë ditë kalendarike përpara Datës së mbylljes, me qëllim që Marrëveshja e blerjes, me përmbajtje si në formën e dhënë në shtojcën 6, të paraqitur Huadhënësit, të jetë në fuqi dhe efekt të plotë (vetëm pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje);

(iii) opinionin ligjor nga Departamenti Ligjor i Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës, me atë përmbajtje si në formën e dhënë në Shtojcën 5, së bashku me kopjet e vërtetuara të miratimeve ose autorizimeve të përmendura në këtë opinionin ligjor;

(iv) mostra të nënshkrimeve të personit ose personave të autorizuar për të nënshkruar dhe dërguar këtë Marrëveshje dhe për të vërtetuar në emër të Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje, të vërtetuar dhe/ose legalizuar nga Departamenti Ligjor i Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës;

(v) mostrat e nënshkrimeve të secilit person të autorizuar, të vërtetuar dhe/ose të legalizuar nga personi që ka nënshkruar këtë marrëveshje ose nga Departamenti Ligjor i Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës;

(vi) mostra të vërtetuara të nënshkrimeve të personit ose personave të autorizuar për të nënshkruar njoftimet që duhet t'i jepen Huadhënësit në emër të Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje;

(vii) kopjet e dokumenteve identifikuese me foto të çdo personi të përmendur në pikat (v) dhe (vi) më sipër, të vërtetuara dhe/ose të legalizuara nga personi që ka nënshkruar këtë marrëveshje ose nga Departamenti Ligjor i Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës;

(viii) konfirmimin e pranimit të agjentit të procesit nga agjencia, me përmbajtje si në formën e dhënë në shtojcën 7;

(ix) pagesën e tarifës se menaxhimit sipas seksionit 4.2;

(x) pagesën e të gjitha kostove dhe shpenzimeve (nëse ka ndonjë) të pagueshme sipas Seksionit 4.6 a);

(xi) Garancinë e OeKB-së;

(xii) pagesën e pjesës avancë të primit të Garancisë së OeKB-së sipas seksionit 4.3 a);

(xiii) pagesën e tarifës së trajtimit të OeKB-së sipas seksionit 4.5;

(xiv) një marrëveshje ri-financimi me OeKB-në për shumën e kredisë;

(xv) një marrëveshje plotësuese midis huadhënësit dhe eksportuesit të projektit;

(xvi) kopjen origjinale të kësaj marrëveshjeje të ekzekutuar me kohë siç duhet nga huamarrësi;

(xvii) konfirmimin nga eksportuesi i projektit dhe nga blerësi i projektit për pranimin e tyre të procedurës së pagesës;

(xviii) të tjera dokumente, dëshmi ose autorizime të cilat huadhënësi i konsideron si të dëshirueshme apo të nevojshme (nëse e ka njoftuar për këtë huamarrësin në përputhje me rrethanat) në lidhje hyrjen në dhe kryerjen e transaksioneve të parapara me këtë marrëveshje ose për vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e kësaj marrëveshjeje;

(xix) dokumente të tilla të cilat huadhënësi mund t'i kërkoj si dëshmi e

pajtueshmërisë me dispozitat e Aktit Bankar Austriak lidhur me pastrimin e parave dhe identifikimin e klientit;

(xx) dokumente të tjera të tilla që huadhënësi apo OeKB-ja mund t`i kërkojë arsyeshëm;

(b) Me përmbushjen e të gjitha kushteve të lartpërmendura, Huadhënësi do të njoftojë menjëherë Huamarrësin për këtë qëllim. Nëse këto kushte nuk do të jenë përmbushur brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve kalendarike pas Datës së Mbylljes (ose brenda një periudhe më të gjatë me të cilën mund të dakordohet Huadhënësi), pa cenuar detyrimin e Huamarrësit sipas Seksioneve 4.2 dhe 4.5, atëherë Huadhënësi nuk është i obliguar të disbursojë asnjë huamarrje sipas kësaj Marrëveshje.

(c) Secili prej këtyre dokumenteve dhe njoftimeve të përmendura me sipër do të jenë në gjuhën angleze ose gjermane. Nëse nuk janë në gjuhën angleze ose gjermane, një përkthim i vërtetuar në gjuhën angleze ose gjermane i bashkëlidhet dokumentit të lartpërmendur.

8. RASTET E MOSPËRMBUSHJES SË DETYRIMEVE

8.1 Rastet e mos-përmbushjes së detyrimeve

Secili prej rasteve të mëposhtme përbën një Rast të Mos-përmbushjes së Detyrimeve:

(a) Huamarrësi nuk paguan në datën për pagesë ndonjë shumë të pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje në vendin dhe valutën në të cilën është e pagueshme, përveç nëse dështimi i tij për paguar është shkaktuar nga ndonjë gabim administrativ ose teknik; dhe pagesa bëhet brenda 10 (dhjetë) ditësh pune nga dita për pagesë;

(b) Huamarrësi nuk respekton dispozitat e kësaj Marrëveshjeje (të tjera nga ato të referuara në Seksionin 8.1 (a) më lart;

(c) Çdo përfaqësim ose deklaratë e bërë ose konsiderohet të jetë bërë nga Huamarrësi në këtë Marrëveshje, ose në ndonjë dokument tjetër të dorëzuar nga ose në emër të Huamarrësit sipas ose në lidhje me këtë Marrëveshje, është ose vërtetohet se ka qenë e pasaktë ose mashtruese në çdo aspekt material kur është bërë ose konsiderohet të jetë bërë;

(d) (i) ndonjë borxh i jashtëm i Huamarrësit nuk është paguar në kohën e duhur brenda çdo periudhe mospagimi (grejs) të aplikueshme fillimisht ose deklarohet të jetë ose përndryshe bëhet i pagueshëm para maturimit të tij të specifikuar si rezultat i një rasti të mospërmbushjes (megjithatë i përshkruar) ose, ii) ndonjë i Huamarrësit për borxh të jashtëm anulohet ose pezullohet nga kreditori përkatës i Huamarrësit, si rezultat i një rasti të mospërmbushjes (megjithatë i përshkruar) ose, (iii) ndonjë kreditor i Huamarrësit fiton të drejtën për të deklaruar ndonjë borxh të jashtëm të Huamarrësit të pagueshëm para maturimit të tij të specifikuar si rezultat i një rasti të mospërmbushjes (megjithatë i përshkruar);

(e) çdo licencë, pëlqim, regjistrim ose aprovim (qeveritar apo tjetër) të kërkuara për vlefshmërinë, zbatueshmërinë ose ligjshmërinë e kësaj Marrëveshjeje ose Huaje ose ekzekutimi i të cilave është tërhequr ose për ndonjë arsye pushon së qenuri në fuqi dhe efekt të plotë;

(f) shpallja e moratoriumit mbi detyrimet e pagesës së borxhit të jashtëm të Huamarrësit, apo Huamarrësi nuk është në gjendje të paguajë borxhin e tij të jashtëm sipas afateve ose fillon negociatat me ndonjë ose më shumë prej kreditorëve të tij të huaj me qëllim të përshtatjes ose ri-programimit të përgjithshëm të Borxhit të tij të Jashtëm;

(g) Huamarrësi pushon së qeni anëtar i pozicionuar mirë ose humb të drejtën për të përdorur mjetet e Fondit Monetar Ndërkombëtar.

(h) Përmbushja e detyrimeve të Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje është ose bëhet e paligjshme (duke përfshirë, pa kufizime, në çdo rast të tillë për shkak të sanksioneve).

(i) Huamarrësi hedh poshtë këtë Marrëveshje ose evidenton një qëllim për të mohuar këtë Marrëveshje.

(j) Garancioni i OeKB dhe/ose marrëveshja e ri-financimit me OeKB për Shumën e Kredisë pushon së qeni në fuqi dhe efekt të plotë;

(k) Banka Qendrore (ose ndonjë autoritet tjetër kompetent) e Republikës së Kosovës të kryej ndonjë veprim apo kujdes të nevojshëm për t'i mundësuar Huamarrësit t`i shlyej detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje në euro;

(l) Çdo rast apo seri rastesh që ndodh(in) dhe që kanë, ose sipas mendimit të arsyeshëm të Huadhënësit, mund të pritet të kenë efekt negativ material në aftësinë e Huamarrësit për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje,

megjithatë, me kusht që asnjë nga Rast mospërmbushjeje sipas seksionit 8.1 e (b), (c), (d), (e) dhe (l) më sipër nuk do të ndodh nëse është e mundshme të korrigjohet një rast i tillë i mos-përmbushjes dhe i njëjti nuk korrigjohet brenda 30 (tridhjetë) ditëve të punës nga cilado që bëhet më herët (i) Huadhënësi njofton me shkrim për Huamarrësin ose (ii) Huamarrësi bëhet i vetëdijshëm për këtë vonesë.

8.2 **Masat për Rastet e Mos-përmbushjes së Detyrimeve**

(a) Nëse ka ndodhur një rast i mos-përmbushjes së detyrimeve dhe në çdo kohë më pas ndonjë ose të gjitha prej masave të mëposhtme që mund të merren nga Huadhënësi do të jenë të vazhdueshme:

(i) Huadhënësi, me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Huamarrësit, mund

të shpallë kryegjënë dhe interesin e grumbulluar në lidhje me Huan dhe të gjitha shumat e tjera të pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje, si menjëherë të kërkueshëm dhe të pagueshëm, pas së cilit do të bëhen menjëherë të kërkueshëm dhe të pagueshëm; dhe/ose

(ii) Huadhënësi, me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Huamarrësit, mund të shpallë të përfunduar Shumën e Kredisë, pas të cilës detyrimi i Huadhënësit për të realizuar dhe vazhduar Huan sipas kësaj Marrëveshjeje, do të përfundojë menjëherë; dhe/ose

(iii) çdo masë tjetër që Huadhënësi mund të vendosë të marrë, sipas diskrecionit të tij absolut.

(b) Huamarrësi bie dakord ta dëmshpërblej Huadhënësit, sipas kërkesës, për të gjitha humbjet, shpenzimet e arsyeshme dhe detyrimet që Huadhënësi i vuan si pasojë e mos-përmbushje të detyrimeve (duke përfshirë por pa u kufizuar në ndonjë interes të paguar nga Huadhënësi për huadhënësit e fondeve të marra hua nga ai për t`i shlyer shuma të vonuara). Një vërtetim nga një nëpunës i autorizuar rregullisht i Huadhënësit që përcakton shumën e këtyre humbjeve, shpenzimeve të arsyeshme dhe detyrimeve dhe bazën e llogaritjes së tyre, kur i paraqiten Huamarrësit (përveç ndonjë gabimi të dukshëm) do të jenë prova përfundimtare të sasisë së këtyre humbjeve, shpenzimeve dhe detyrimeve, me kusht që ky vërtetim të mbështetet nga dokumente që japin të dhëna për këto humbje, shpenzime dhe detyrime dhe këto vërtetime do të mbështeten nga dokumente të caktuara.

(c) Huamarrësi, sapo të vihet në dijeni për këtë, do t'i japë njoftim me shkrim Huadhënësit për:

(i) çdo Rast të Mos-përmbushjes së Detyrimeve; ose

(ii) çdo kusht, ngjarje ose veprim që, me dhënien e njoftimit ose kalimin e kohës ose të dyjave, ose përmbushjen e ndonjë kushti, mund të çonte ose përbënte një Rast të Mos-përmbushjes së Detyrimeve.

9. GARANCITË DHE ANGAZHIMET

9.1 Garancitë

Huamarrësi jep garancitë e mëposhtme në datën efektive:

(a) Huamarrësi ka autoritetin për të lidhur këtë Marrëveshje dhe për të marrë hua sipas kësaj Marrëveshje dhe për të ekzekutuar, liferuar dhe realizuar këtë Marrëveshje dhe ka marrë të gjitha masat e nevojshme për t`i autorizuar termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe për të lejuar ekzekutimin, liferuar dhe realizuar këtë Marrëveshje;

(b) të gjitha autorizimet, licencat, pëlqimet, regjistrimet ose miratimet (qeveritare ose të tjera) të domosdoshme nga ana e Huamarrësit në lidhje me ekzekutimin,

liferimin, realizimin, vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e kësaj Marrëveshjeje janë marrë ose realizuar dhe janë në fuqi dhe efekt të plotë;

(c) Kjo Marrëveshje përbën një detyrim ligjor, të vlefshëm dhe detyrues të Huamarrësit, të zbatueshëm në përputhje me kushtet e saj;

(d) ekzekutimi, liferimi dhe realizimi i kësaj Marrëveshjeje nuk do të shkelë asnjë dispozitë të ndonjë ligji ose rregullore ekzistuese të zbatueshme për Huamarrësin ose ndonjë marrëveshje, kontrate ose ndërmarrjeje tjetër në të cilën Huamarrësi është palë ose që është e detyrueshme për atë ose aktivet e tij;

(e) Huamarrësi nuk është në mospërmbushje të pagesës së ndonjë prej borxheve të tij të jashtëm dhe nuk ka ndodhur dhe nuk po vazhdon asnjë Rast i Mos-përmbushjes së Detyrimeve dhe i cili është i arsyeshëm të pritet të rezultojë nga ndonjë Huamarrje;

(f) Zgjedhja e ligjit austriak si ligji rregullues i kësaj Marrëveshjeje dhe çdo vendim ose gjykim arbitrar i marrë në Austri në lidhje me këtë Marrëveshje, do të njihet dhe zbatohet në Republikën e Kosovës.

(g) Detyrimet e Huamarrësit për pagesë, sipas kësaj Marrëveshje, renditet së paku *pari passu* me pretendimet e të gjithë kreditorëve të tij të tjerë të pasigurt dhe jo të varur, përveç obligimeve të detyrueshme me ligjin në fuqi.

(h) Sipas ligjit të Republikës së Kosovës, nuk kërkohet që të bëhet ndonjë zbritje për ose në emër të tatimit mbi ndonjë pagesë që mund të bëhet sipas kësaj Marrëveshjeje.

(i) Sipas ligjit të Republikës së Kosovës, nuk është e nevojshme që kjo Marrëveshje të deponohet, protokollohet ose regjistrohet në ndonjë gjykatë apo autoritet tjetër në Republikën e Kosovës ose që të paguhet ndonjë vulë, regjistrim ose taksë e ngjashme në lidhje të kësaj Marrëveshje ose transaksionet e parapara me këtë Marrëveshje.

(j) Huamarrësi nuk ka të drejtë të kërkojë imunitet për veten ose ndonjë nga aktivet e tij në lidhje me ndonjë procedurë të nisur në lidhje me këtë Marrëveshje;

(k) Ekzekutimi i kësaj Marrëveshje nga Huamarrësi përbën, ndërsa ushtrimi i të drejtave dhe përmbushja e detyrimeve të Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshje do të përbëjë, veprime të bëra dhe kryera për qëllime private dhe komerciale.

(l) Huamarrësi është anëtar i pozicionuar mirë dhe ka të drejtë të përdorë mjetet e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe nuk ka pasur ndonjë ndryshim negativ material në gjendjen financiare të Huamarrësit që nga data e Raportit të Vendit të FMN-së nr. 17/68 për Republikën e Kosovës, i përgatitur nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe i publikuar më 17 mars 2017, i cili është pranuar nga Huamarrësi.

(m) Në lidhje me këtë Marrëveshje dhe në lidhje me detyrimet dhe të drejtat e tij sipas kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi vepron si kryesori dhe për llogari të vetë dhe jo si agjent ose administrues i besuar ose në ndonjë rol tjetër në emër të ndonjë pale tjetër.

(n) As Huamarrësi, as Blerësi i Projektit nuk kanë krijuar ose kanë rënë dakord për të vendosur ndonjë Siguri mbi tërë ose në ndonjë pjesë të mallrave të furnizuara në pajtim me Marrëveshjen e Blerjes.

(o) Sipas njohurive dhe besimit të tyre më të mirë, as Huamarrësi, as Blerësi i Projektit, as ndonjë nga degët e tij, ose zyrtarët, drejtorët, punonjësit ose agjentët që veprojnë në emër të tij nuk kanë ofruar, dhënë, këmbëngulur në, marrë ose kërkuar ndonjë pagesë të paligjshme ose avantazh të pahijshëm për të ndikuar në veprimin e ndonjë personi në lidhje me këtë Marrëveshje.

(p) Huaja nuk do të përdoret, huazohet, nuk do të kontribuohet ose të vihet në dispozicion në ndonjë mënyrë apo për ndonjë qëllim që ndalohet nga Sanksionet ose që do të rezultonte në shkelje të Sanksioneve nga Huamarrësi ose ndonjë nga agjencitë e tij (ose ndonjë nga punonjësit ose agjentët e tij që veprojnë në emër të tyre);

(q) As Huamarrësi, as ndonjë nga agjencitë e tij (as ndonjë nga zyrtarët, punonjësit apo agjentët e tyre që veprojnë në emër të tyre), për aq sa është i vetëdijshëm, nuk është Person i Bllokuar, ose është ndryshe subjekt i Sanksioneve.

Garancitë e paraqitura më lart do të vazhdojnë edhe pas ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje dhe do të konsiderohen të përsëritura në çdo datë të Huamarrjes dhe në çdo Datë të Shlyerjes së Interesit.

9.2 **Angazhimet**

Huamarrësi zotohet dhe merr përsipër me dhe për Huadhënësin, si më poshtë:

(a) Huamarrësi do të (dhe do të sigurojë që Blerësi i Projektit do të):

(i) (x) të mbajë të dhëna të mjaftueshme për të identifikuar mallrat dhe shërbimet e financuara nga Huaja, (y) informon në lidhje me përdorimin e tyre në Projekt dhe (z) regjistron ecurinë e Projektit, duke përfshirë koston e tij;

(ii) t'i lejojë Huamarrësit dhe/ose përfaqësuesve të OeKB-së të inspektojnë Projektin, ndërmarrjen e Blerësit të Projektit, mallrat dhe shërbimet e furnizuara në pajtim me Marrëveshjen e Blerjes dhe çdo të dhënë dhe dokument përkatës;

(iii) t'i ofroj Huadhënësit të gjithë informacionin e tillë që Huadhënësi kërkon lidhur me shpenzimet e Huas, Projektin si dhe mallrat dhe shërbimet e furnizuara sipas Marrëveshjes së Blerjes.

(b) Detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje klasifikohen të paktën *pari passu* dhe të barabarta me të gjitha detyrimet e tjera të jashtme të papaguara dhe të pasiguruara dhe të pavarura të Huamarrësit, përveç obligimeve të detyrueshme me ligjin në fuqi.

(c) Huamarrësi nuk do të (ose do të sigurojë që Blerësi i Projektit nuk do të) krijojë ose të lejojë të ekzistencën e ndonjë mase siguruese mbi ndonjë nga mallrat e furnizuara në pajtim me Marrëveshjen e Blerjes, përveç ndonjë barre që lind nga zbatimi i ligjit.

(d) Nga data e kësaj Marrëveshjeje dhe përderisa një pjesë e Huas do të mbetet e papaguar, Huamarrësi nuk do të krijojë ose të bie dakord të krijojë ndonjë masë sigurie mbi të gjitha ose ndonjë pjesë të aktiveve të tij për të siguruar ndonjë Borxh të Jashtëm ose për të siguruar një garanci të ndonjë Borxhi të Jashtëm, përveç nëse Huaja sigurohet në mënyrë të barabartë dhe të përpjesshme të pranueshme për Huadhënësin.

(e) Huamarrësi nuk do të (dhe do të sigurojë që blerësi i projektit nuk do të) ndryshojë, variojë, ripërtërijë, shtoj, shfuqizojë, heqë dorë, pezullojë funksionimin e, hedh poshtë ose përfundojë ndonjë nga afatet e Marrëveshjes së Blerjes pa pëlqimin paraprak me shkrim të Huadhënësit dhe OeKB-së.

(f) Huamarrësi do t`i përmbush në të gjitha aspektet të gjitha kërkesat e Huadhënësit që dalin nga kërkesat e OeKB-së të cilat i janë vendosur Huamarrësit sipas ose për shkak të Garancionit të OeKB.

(g) Huamarrësi do të sigurojë që as ai, as ndonjë zyrtar, drejtor, punonjës ose agjent i tij që vepron në emër të tij nuk do të ofrojë, nuk do të këmbëngulë, nuk do të marrë ose nuk do të kërkojë ndonjë pagesë të paligjshme ose avantazh të pahijshëm për të ndikuar në veprimin e ndonjë personi në lidhje me këtë Marrëveshje.

(h) Huamarrësi nuk duhet:

(i) të mbajë ose të ndërmerr, ose të mos mbajë ose të mos ndërmerr ndonjë veprim apo sjellje që do të shkaktonte që Huadhënësi të jetë në kundërshtim me ndonjë Sanksion;

(ii) të përdorë, huazojë, kontribuojë ose ndryshe të vë në dispozicion, drejtpërdrejt ose tërthorazi, mjetet ose shërbime të tjera të ofruara nga Huadhënësi tek Huamarrësi për çdo qëllim që mund të çojë në shkelje ose kundërvajtje të çfarëdo sanksionesh nga Huadhënësi; dhe

(iii) të veprojë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, për ose në emër apo në drejtimin e ndonjë Personi të Bllokuar, ose në një mënyrë që do të kontribuonte në shkelje ose në kundërshtim me çfarëdo Sanksionesh nga Huadhënësi.

(i) Huamarrësi do të:

(i) njoftojë menjëherë Huadhënësin dhe t'i jep Huadhënësit të gjitha dokumentet të cilat Huadhënësi i konsideron të nevojshme në ndonjë rast kur ndonjë veprim, çështje ose gjë që duhet të bëhet ose kryhet nga Huadhënësi, kërkon autorizim paraprak nga çdo autoritet kompetent për shkak të Sanksioneve; dhe

(ii) të njoftojë menjëherë Huadhënësin, pasi të bëhet i vetëdijshëm për ndonjë rast ose rrethanë që ka ndodhur në lidhje me Sanksionet nga e cila mund të pritet në mënyrë të arsyeshme që të rezultojë në të drejtën për të kërkuar pagesë nga ana e Huadhënësit sipas pikës 8.1 (h) (*Rasti i mos-përmbushjes së Detyrimeve*).

(j) Huamarrësi do të sigurojë që të përfshihet dispozita në buxhetin kombëtar të Republikës së Kosovës për secilin vit financiar për pagesën ose shlyerjen e kërkueshme dhe të përpiktë nga huamarrësi të interesit, kryegjësë dhe shumave tjera për t'u paguar në vijim dhe që planifikohet të bëhen gjatë atij viti financiar i cili do të përfshijë paratë e kërkueshme sipas kësaj marrëveshjeje.

10. LIGJI RREGULLUES DHE ARBITRAZHI

10.1 Ligji rregullues

Kjo Marrëveshje rregullohet nga ligji i Republikës së Austrisë.

10.2 Arbitrazhi

(a) Çdo mosmarrëveshje, kundërshti apo pretendim që lind nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje, duke përfshirë çdo pyetje që mund të lind në lidhje me krijimin, ekzistencën, vlefshmërinë, efektin, ndërprerjen, interpretimin, kryerjen apo shkeljen e Marrëveshjes, apo marrëdhëniet ligjore të përcaktuara në të (duke përfshirë kërkesat për dëmshpërblim apo kundërkërkesë) (një '**Mos-marrëveshje**') do t'i referohen, dhe përfundimisht do të zgjidhen nga arbitrazhi sipas Rregullave të Arbitrazhit dhe Pajtimit të Qendrës Ndërkombëtare të Arbitrazhit të Dhomës Ekonomike Federale të Austrisë në Vjenë (Rregullat e Vjenës), në fuqi në datën në të cilën procedurat janë referuar për arbitrazh. ("**Rregullat**").

(b) Do të ketë tre arbitra të emëruar në pajtim me Rregullat; vendi i arbitrazhit do të jetë Vjenë, Austri; gjuha e arbitrazhit do të jetë gjuha angleze.

(c) Çdo vendim i tribunalit të arbitrazhit do të jetë përfundimtar dhe i detyrueshëm dhe palët e kësaj Marrëveshje, në mënyrë të parevokueshme, do të heqin dorë nga çfarëdo e drejte për çdo formë të ankesës, rishikimit ose adresim në ndonjë shtet ose autoritet tjetër gjyqësor, përderisa një heqje dorë e tillë mund ishte valide.

(d) Asgjë në këtë klauzolë nuk do të ndalojë Huadhënësin që të kërkojë ndonjë

lehtësim të përkohshëm paraprak ose mjete paraprake për çfarëdo qëllimi nga tribunali i arbitrazhit ose nga ndonjë gjykatë ose juridiksion kompetent.

(e) Në çdo procedurë të arbitrazhit, certifikata e Huadhënësit në lidhje me ndonjë shumë për shkak të huadhënësit do të jetë provë prima facie e shumës së tillë.

10.3 **Agjenti i procesit**

(a) Pa cenuar ndonjë mënyrë tjetër shërbimi të lejuar sipas ndonjë ligji përkatës, Huamarrësi, në mënyrë të parevokueshme, emëron Ambasadën e Republikës së Kosovës në Republikën e Austrisë si agjent të tij për shërbimin e procesit në lidhje me çdo procedurë të përmendur në seksionin 10.2 më sipër. Huamarrësi pajtohet që dështimi i agjentit të procesit për të njoftuar Huamarrësin për procesin nuk do të zhvlerësojë procedurat në fjalë dhe do të emërojë menjëherë një agjent tjetër procesi nëse agjenti aktual i procesit nuk mund të kryejë më detyrat e tij.

(b) Huamarrësi do t'i sigurojë Huadhënësit pranimin e një emërimi të tillë në një formular të dhënë në Shtojcën 7.

10.4 **Imuniteti**

(a) Në masën më të plotë të lejuar nga ligjet e Republikës së Kosovës, Huamarrësi, në mënyrë të parevokueshme dhe pa kushte, heq dorë përgjithësisht nga imuniteti që ai ose aktivet ose të ardhurat e tij mund të kenë ndryshe në ndonjë juridiksion, përfshirë imunitetin në lidhje me (i) dhënien e ndonjë lehtësimi përmes vendimit ose urdhrit për përmbushje specifike ose për rikuperimin e aktiveve ose të të ardhurave; dhe (ii) inicimin e ndonjë procesi kundër aktiveve ose të ardhurave të tij për zbatimin e një vendimi ose vendimi të arbitrazhit ose, në një veprim ad rem (përkatës), për arrestimin, ndalimin ose shitjen e ndonjë prej aktiveve ose të ardhurave të tij.

(b) Pavarësisht nga sa më sipër, Huamarrësi nuk heq dorë nga imuniteti i tillë në lidhje me (i) pronën e tij të misionit diplomatik apo konsullor të Republikës së Kosovës, (ii) pronën e karakterit ushtarak dhe nën kontrollin e një autoriteti ushtarak ose agjencie mbrojtëse, (iii) pronën që gjendet në Republikën e Kosovës dhe që është e dedikuar për përdorim publik ose qeveritar.

11. **TË PËRGJITHSHME**

11.1 **Njoftimet**

(a) Çdo komunikim në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të jetë me shkrim në gjuhën angleze dhe mund të bëhet me postë, faks ose me ndonjë mjet të komunikimit elektronik. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, një komunikim elektronik do të trajtohet sikurse me shkrim.

(b) Detajet e kontaktit për të gjitha njoftimet në lidhje me këtë Marrëveshje janë të përcaktuara në Shtojcën 1. Çdo Palë mund të ndryshojë detajet e veta të kontaktit

duke i dhënë një njoftim prej pesë ditë pune Palës tjetër. Kur një Palë cakton një departament ose një zyrtar të veçantë për të marrë një njoftim, një njoftim nuk do të jetë i plotfuqishëm nëse nuk e specifikon atë departament ose zyrtar.

(c) Përveç siç parashikohet më poshtë, çdo njoftim në lidhje me këtë Marrëveshje do të konsiderohet të jetë dhënë:

(i) nëse është nisur me postë, pesë ditë pas dorëzimit në postë, me postë të parapaguar, në një zarf të adresuar saktë me një kopje të dorëzuar me faks ose me e-mail;

(ii) nëse me faks, kur pranohet në formë të lexueshme; dhe

(iii) nëse me e-mail ose ndonjë komunikimi tjetër elektronik, pas pranimit.

Çdo komunikim i pranuar në një ditë jo pune ose pas orarit të punës në vendin e pranimit do të konsiderohet se është dhënë ditën e ardhshme të punës në atë vend.

11.2 **Heqjet dorë, mjetet ligjore kumulative**

Asnjë pamundësi ose vonesë e Huadhënësit në ushtrimin e një të drejte, kompetence ose privilegji sipas kësaj Marrëveshjeje dhe asnjë kur ndërveprimi mes Huamarrësit dhe Huadhënësit nuk nënkupton si heqje dorë nga to; një ushtrim i vetëm ose i pjesshëm i një të drejte, kompetence ose privilegji sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të përjashtojë një ushtrim tjetër ose të mëtejshëm të tyre ose ushtrimin e një të drejte, kompetence ose privilegji tjetër. Të drejtat dhe mjetet ligjore në këtë marrëveshje të parashikuara shprehimisht janë kumulative dhe nuk janë ekskluzive për ndonjë të drejtë ose mjet ligjor që Huadhënësi do të kishte ndryshe. Asnjë njoftim ose kërkesë ndaj Huamarrësit në ndonjë rast nuk autorizon Huamarrësin për njoftim ose kërkesë tjetër të mëtejshme në lidhje me të njëjtat rrethana ose nuk përbën heqje dorë nga të drejtat e Huadhënësit për ndonjë veprim tjetër ose të mëtejshëm në lidhje me këto rrethana, pa njoftim ose kërkesë.

11.3 **Pavlefshmëria e pjesshme**

Nëse, në çdo kohë, një prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje është apo bëhet e paligjshme, pavlefshme ose e pazbatueshme në çfarëdo kuptimi sipas ndonjë ligji të ndonjë juridiksioni, as ligjshmëria, vlefshmëria apo zbatueshmëria e dispozitave të mbetura, e as ligjshmëria, vlefshmëria apo zbatueshmëria e dispozitave të tilla sipas ligjit të çdo juridiksioni tjetër, nuk do të cenohet ose dëmtohet dhe palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të rishikuar dispozitën e pavlefshme në mënyrë që ta bëjnë atë të zbatueshme në përputhje me qëllimin e shprehur aty.

11.4 **Transferimi**

(a) Sipas kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi nuk mund të caktojë ose transferojë të gjitha ose një pjesë të të drejtave dhe detyrimeve të tij, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Huadhënësit.

(b) Huadhënësi mund t'i caktojë ose transferojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet sipas kësaj Marrëveshje në tërësi ose pjesërisht:

(i) OeKB-së;

(ii) Republikës së Austrisë

(iii) ndonjë anëtari të UniCredit Group

pa pëlqimin paraprak të Huamarrësit.

(c) Huadhënësi mund t'i caktojë ose transferojë të gjitha ose një pjesë të të drejtave dhe detyrimeve të tij, në tërësi ose pjesërisht, për ndonjë përfitues tjetër me pëlqimin paraprak të Huamarrësit, me kusht që megjithatë:

(i) një pëlqim i tillë nuk duhet të refuzohet pa arsye dhe të konsiderohet se është dhënë në qoftë Huadhënësi nuk ka marr kurrfarë përgjigje nga Huamarrësi brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga dorëzimi i kërkesës për pëlqim; dhe

(ii) një pëlqim i tillë nuk kërkohet nëse një Rast i Mos-përmbushjes së Detyrimeve ose një Rast potencial i mos-përmbushjes së Detyrimeve ka ndodhur dhe vazhdon.

11.5 **Ndryshimet e Marrëveshjes**

Kjo Marrëveshje nuk mund të modifikohet ose ndryshohet përveçse me instrumente me shkrim.

11.6 **Konfidencialiteti**

(a) Varësisht nga Seksioni 11.6 (b) dhe (c) më poshtë, të gjitha informacionet në lidhje me këtë Marrëveshje, qoftë në formë të shkruar ose verbale, do të jenë konfidenciale përveç nëse kanë arritur në domenin publik. Secila Palë ("Pala e Parë") merr përsipër që, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës tjetër, nuk do t'i zbulojë ndonjë informacion të tillë konfidencial ndonjë personi:

(i) me përjashtim të drejtorëve, punonjësve, agjentëve dhe/ose këshilltarëve të Palës së Parë, ose ndonjë dege ose agjencie të Palës së Parë, ndaj të cilëve, sipas mendimit të Palës së Parë, shpalosja e informacionit të tillë është i domosdoshëm për t'i mundësuar Palës së Parë t`i përmbush detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje;

(ii) përveç se për të përmbushur kushtet ligjore apo një kërkesë të ndonjë agjencie qeveritare ose rregullatore ose në lidhje me ndonjë çështje gjyqësore, të arbitrazhit ose procedura të tjera gjyqësore; ose

(iii) me përjashtim të drejtorëve, punonjësve, agjentëve dhe/ose këshilltarëve të Palës së Parë, ose ndonjë dege ose agjencie të Palës së Parë, ndaj të cilëve,

sipas mendimit të Palës së Parë, shpalosja e informacionit të tillë është i domosdoshëm për t'i mundësuar Palës së Parë t`i bindet rregulloreve të brendshme që mund të miratohen kohë pas kohe.

(b) Huadhënësi mund t'i shpalosë çdo informacion në lidhje me këtë Marrëveshje:

(i) OeKB-së;

(ii) Republikës së Austrisë;

(iii) Eksportuesit të projektit;

(iv) çdo anëtari të UniCredit Group; dhe

(v) një drejtëmarrësi apo të transferuari të mundshëm ose çdo personi ose kompanie tjetër që mund të propozojë hyrjen në marrëdhënie kontraktuale me Huadhënësin në lidhje me këtë Marrëveshje

dhe siguron që personat e tillë e trajtojnë informacionin e dhënë si konfidencial në masën e përcaktuar në pikën (a) më sipër.

(c) Huadhënësi me këtë konfirmon se është informuar se teksti i kësaj Marrëveshjeje publikohet në "Gazetën Zyrtare" të Republikës së Kosovës.

11.7 **Gjuha dhe kopjet**

(a) Kjo Marrëveshje përpilohet në të dyja versionet anglisht dhe shqip në dy kopje origjinale, me nga një kopje për secilën palë.

(b) Palët pajtohen se versioni në gjuhën angleze do të mbizotërojë për qëllimet e interpretimit të kësaj Marrëveshjeje.

11.8 **Hyrja në fuqi**

(a) Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën efektive kur nënshkruhet nga Palët, dhe pas ratifikimit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe publikimit në "Gazetën Zyrtare" të Republikës së Kosovës.

(b) Huamarrësi do të njoftojë menjëherë Huadhënësin për aktin e publikimit të kësaj Marrëveshjeje në "Gazetën Zyrtare" të Republikës së Kosovës.

(c) Kjo Marrëveshje do të pushoj dhe nuk do të hyj në fuqi nëse data e hyrjes në fuqi nuk ndodh me ose para 3 muaj nga data e kësaj Marrëveshjeje, *të shënohet data*..... ose një datë të mëvonshme të rënë dakord me Huadhënësin.

SHTOJCA 1

PALËT

Huamarrësi:

Emri:	Republika e Kosovës, që vepron përmes Ministrisë së Financave
Departamenti:	Thesari
Adresa:	Ndërtesa e re e qeverisë;
	Nëna Terezë pn; 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel:	+ 381 38 200 34 026
Faks:	+ 381 38 212 362
E-maili	debtunit@mf-rks.org
Në vëmendje të.	Znj. Ardita Haxhiaj

Huadhënësi

Emri:	UNICREDIT BANK AUSTRIA AG
Adresa:	Rothschildplatz 1
	1020 Vienna, Austria
Departamenti:	8243 STEF Structured Trade & Export Finance
Tel:	+ 43 50505 - 56919
Faksi:	+ 43 50505 - 8956910
E-maili	Markus.Kehle@unicreditgroup.at
Në vëmendje të.	Z. Markus Kehle

SHTOJCA 2

PROJEKTI

Projekti:

Ndërtimi i sistemit të kanalizimit në Komunën e Shtimes me një vlerë të përgjithshme të projektit prej EUR 2,385,000 (dy milionë e treqind e tetëdhjetë e pesë mijë euro).

Eksportuesi i projektit:

ÖSTAP Engineering & Consulting GmbH
Heiligenstädter Straße 51/3
1190 Vienna, Austria

Blerësi i Projektit:

Komuna e Shtimes
Tahir Sinani 50
72000 Shtime, Kosovë

Marrëveshja e Blerjes:

Kontrata për realizimin e projektit për ndërtimin e sistemit të kanalizimit në Komunën e Shtimes e datës 21 qershor 2018 ndërmjet Komunës së Shtimes si punëdhënës dhe ÖSTAP Engineering & Consulting GmbH si kontraktues.

SHTOJCA 3

SHUMA E KREDISË

1. **Shuma e Kredisë** (**Seksioni** 2.1)

   Një shumë që nuk kalon EUR 2,385,000 (dy milionë e treqind e tetëdhjetë e pesë mijë euro)

2. **Periudha e Disponueshmërisë** (**Seksioni** 2.1 b)

   Periudha nga dhe përfshirë edhe Datën e Mbylljes (siç përcaktohet në Seksionin 7) deri më, duke përfshirë edhe datën që bie para:

   (i) 18 (tetëmbëdhjetë) muaj pas Datës së Mbylljes; dhe

   (ii) 30 qershor 2020

   Apo ndonjë datë të mëvonshme siç mund ta specifikoj Huadhënësi me kalimin e kohës.

3. **Interesi** (Seksioni 3.1)

   0 (zero) për qind në vit

4. **Kamatëvonesa** (Seksioni 3.3)

   Kostot e ri-financimit të Huadhënësit bazuar në normën e interesit siç përcaktohen në mënyrë të arsyeshme nga Huadhënësi në atë kohë (dhe nëse norma e interesit është nën zero, norma e interesit do të konsiderohet zero) plus marzha prej 2 për qind (dy për qind) p.a.

5. **Tarifa e Zotimit** (Seksioni 4.1)

   0.5 % p.a. (zero pikë pesë për qind në vit)

6. **Tarifa e Menaxhimit** (Seksioni 4.2)

   0.5% (zero pikë pesë për qind) paushalli i shumës së përgjithshme të Shumës së Kredisë.

7. **Primi i garancionit të OeKB i pagueshëm në avansë** (Seksioni 4.3 a)

EUR 9.838,13 (nëntë mijë e tetëqind e tridhjete e tetë euro e 13/100] (si tregues në datën e kësaj Marrëveshje).

Shuma përfundimtare do të përcaktohet nga OeKB pas lëshimit të Garancionit të OeKB.

8. **Primi i garancionit të OeKB i pagueshëm si marzhë** (Seksioni t 4.3 b)

1.10 % në vit (një pikë përqindjeje në vit)] (si tregues në datën e kësaj Marrëveshje)

Norma përfundimtare do të përcaktohet nga OeKB pas lëshimit të garancionit të OeKB.

Sipas Garancionit të OeKB, Primi i Garancionit të OeKB-së që paguhet si marzhë mbështetet nga Ministria Federale e Financave të Austrisë me një ulje të motivuar të politikave nga zhvillimet e politikave me 50% në shumën prej 272.188,13 euro (si tregues në datën e kësaj Marrëveshjeje).

9. **Tarifa e Trajtimit e OeKB-së** (Seksioni 4.5)

EUR 1.440,--

11. **Datat e Shlyerjes së detyrueshme** (Seksioni5.1)

Në 23 (njëzet e tri) këste të barabartë gjashtë-mujore të njëpasnjëshme të shlyerjes.

Kësti i parë i tillë i shlyerjes duhet të paguhet në datën në vijim, cilado që vije e para:

(i) 54 muaj pas datës së Certifikatës së Pranimit të Përkohshëm dhe

(ii) 72 muaj pas Datës së Mbylljes; dhe

(iii) 31 dhjetor 2024.

12. **Shuma vullnetare e parapagimit** (Seksioni 5.2)

500.000 Euro

SHTOJCA 4

PROCEDURA E PAGESËS

1. Nuk lejohet asnjë huamarrje përveç nëse:

   (a) shuma e huas së propozuar është më e vogël ose e barabartë me shumën totale të shumës së kredisë minus

      (i) shuma agregate e ndonjë kredie të papaguar në kuadër të Shumës së kredisë; dhe

      (ii) në lidhje me çdo huamarrje të propozuar, shuma agregate e së cilës huamarrje që është për t`u paguar në ose para datës së Huamarrjes së propozuar.

   (b) data e propozuar e huamarrjes bie në një ditë pune brenda periudhës së disponueshmërisë;

   (c) Huadhënësi është i kënaqur që Garancia e OeKB dhe marrëveshja ri-financimit e OeKB të zbatohet në lidhje me Huamarrjen e propozuar dhe gjithë interesin aktual dhe të ardhshëm që lidhet me to;

